Kronikë

Në kërkim për operacionin 'Metamorfoza', forcat RENEA dhe FNSH aksion në Shkodër për arrestimin e Eljon Hatos, mik i Ervis Martinajt

Rreth 50 forca të policisë së Shkodrës, FNSH por edhe një grup i RENEA bëtë një kontroll të befasishëm në një fshat të Shkodrës për arrestimin e Eljon Hato i dyshuar në kërkim si i dyshuar në dosjen "Metamorfoza". Hato nuk ndodhej në banesën e të vëllait, ashtu siç policia kishte marrë informacion

■ VIDEO/ Momenti kur RENEA mësyn banesën

■ Policia i bastisi banesën, kush është Eljon Hato, 'ushtar' i Ervis Martinajt? Vrau moshatarin, e porositi vrasjen e një mjeku nga burgu i Shën Kollit

HOROSKOPI

RAPORTO! Chat live me Shqiptarja.com

Q-antivirus

Redaksia
16 Janar, 09:20 | Përditësimi: 16 Janar, 11:50

Share

SHKODËR- Nuk pati suksesin që pritej, operacioni për kapjen e Eljon Hatos, i njohur si miku i ngushtë i Ervis Martinaj, në kërkim si i dyshuar në dosjen "Metamorfoza". Emri i tij, u bë i dëgjuar, në vrasjen e bujshme në zonën e ish-blokut në vitin 2018, ku mbeti i plagosur në përplasjen me armë brenda lokal "Monopol" ku u vra, truproja i Martinajt, Fabiol Gaxha.

Forcat RENEA dhe FNSH kishin marrë informacion se në dritë e fundit, Hato lëvizte përreth zonës dhe mund të ishte në banesën e të vëllait në Grudë, pasi shtëpinë e tij e ka në Kiras. Ndërhyrja e befasishme e tyre, e më shumë se 50 forcave, të FNSH dhe të RENEA, duke kaluar mbi murin rrethues e prerë telat me gjemba, duke vrarë njërin qen të shtëpisë, e plagosur tjetrin, ka rastur dhe reagimin e familjarëve Hato.

I vëllai Elkieri, thotë se policia ka reaguar dhunshëm si asnjëherë më parë, pa mandat kontrolli, si dhe iu vrau kafshët. 39 vjeçari, baba i dy djemve, 13 vjeç dhe tjetri 3 vjeç, pas kësaj ngjarjeje, ka denoncuar në AMP shefin e komisariatit të policisë së Shkodrës Idriz Daulle, për të cilin thotë se veproi jo sipas ligjit por me qëllime të dyshimta. Lidhur me vendodhjen e vëllait, ai thotë se nuk e ka idenë ku ndodhet dhe beson se nuk donë zotohet.

[Sh.com]

LEXO EDHE:
FNSH dhe RENEA 'blindojnë' Vlorën, kontrolle për persona të shpallur në kërkim! Kapet një 20 vjeçar, iu gjet pistoletë në makinë

Eljon Hato, një emër me rekorde kriminale, ka qenë i përfshirë në ***vrasjen e bujshme*** në zonën e ish-blokut në vitin 2018, ku mbeti i vrarë një person. I konsideruar "ushtari" i Ervis Martinajt, Eljon Hato mbeti i plagosur në përplasjen me armë brenda lokal "Monopol" ku u vra Fabiol Gaxha.

Më herët në 12 maj të vitit 2014, Hato, atëkohë 24 vjeç nën efektin e alkoolit u akuzua për vrasjen e Indrit Yllit gjatë një sherri banal në Zus të Shkodrës. Një vit më vonë kur ai ndodhej në burgun e Shën-Kollit, Hato, u akuzua se porositi vrasjen e mjekut radiolog të spitalit të Shkodrës, Agron Terolli, si hakmarrje për një shok që ishte plagosur nga djali i Terollit. Patur parasysh një profil të tillë criminal, forcat e policisë ishin organizuar fuqishëm.

Lajmi në përditësim....

Rendit zhvillimet sipas orarit: Të Fundit

Ora 09:57

Policia i bastisi banesën, kush është Eljon Hato, 'ushtar' i Ervis Martinajt? Vrau moshatarin, e porositi vrasjen e një mjeku nga burgu i Shën Kollit



Foto: Operacioni i RENEA-s në fshatin Grudë

Policia ka bastisur dje 15 janar, banesën e Eljon Hatos, nje person me rekorde të shumta kriminale, ndërsa njihet edhe si 'ushtar' i Ervis Martinajt.

Elton Hato ka qenë i përfshirë në vrasjen e bujshme në ***zonën e ish-blokut në vitin 2018***, ku mbeti i vrarë Fabiol Gaxha. I konsideruar "ushtari" i Ervis Martinajt, Eljon Hato mbetì i plagosur në përplasjen me armë brenda lokal "Monopol", u arrestua nga policia, por më pas disa ***kohësh u la i lirë***.

Më 12 maj të vitit 2014, Eljon Hato, asokohe 24 vjeç nën efektin e alkoolit ka vrarë një moshatarin e tij pas një sherri banal.

Vrasja e Indrit Hyllit në vitin 2014

Në fshatin Zus në Shkodër, Eljon Hato, asokohe 24 vjeç, ***ka vrarë Indrit Yllin*** si edhe ka plagosur Jetmir Mollën. Policia sqaroi asokohe se autori dhe viktima, bashkë me të plagosurin ndodheshin së bashku në një lokal dhe pas një debati banal, Hato ka njëmrë armë e tij dhe ka qëlluar në drejtim të Indrit Hyllit Por vetëm një vit më pas, në 2015-ën pasi ndodhej në burgun e Shën-Kollit, Eljon Hato, u akuzua se porositi vrasjen e mjekut radiolog të spitalit të Shkodrës, Agron Terolli. Hato kishte "pajtuar" një 21-vjeçar i cili do të kryente vrasjen, por fatmirësisht policia, falë të dhënave në rrugë operative, arriti ta parandalonte ngjarjen e rëndë.

Çfarë e shtyu Eljon Haton të paguante për kokën e mjekut?
Në 2015-ën, djali i doktorit Agron Terrolli, kishte plagosur me armë zjarri pa leje një person duke e lënë të paaftë fizikisht dhe dëmtim për kërdi vepër penale e ka kryer në burgun e Shën Kollit, ku qëndronte për të vuajtur dënimin edhe Eljon Hato. Policia u përgendrua asokohe në pistën e një hakmarrjeje të mundshme të Hatos ndaj djalit të mjekut. Ekzekutimi i mjekut dështoi falë ndërhyrjes në kohë të forcave të policisë që prej kohësh kishin nën vëzhgim 21-vjeçarin Osman Mulja, i paguar për të kryer vrasjen

M.Q./Shqiptarja.com

Share

M.Q./Shqiptarja.com

TAG: Vrasje | eljon hatës | Ervis Martinaj | Renea

Komento

Komente

Kastriot: 16/01/2024 10:52
E kan plagosur qenin or tejj

Përgjigju

Ndalohet rreptësisht ripublikimi i kdolij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016.

Sh.com

Sondazhi i ditës:
Rithemelimi pengon fjalën e Presidentit në Kuvend,si e vlerësoni?

Të drejtë | Të gabuar | Nuk kam mendim

Lajme të tjera

VIDEO/ Pamjet e fundit të Ervis Martinajt, me qesa ushqimesh shkon në shtëpinë e të dashurës, më pas largohet me 'Benz'-in që u gjet i braktisur
10 Janar, 17:41

Konfiskohen pasuritë e Arben Kaçorrit i dënuar në Itali për vrasje
26 Dhjetor 2023, 19:55

Shkodër/ Po peshkonte, 65-vjeçari rrëshqet aksidentalisht në ujërat e lumit Buna! Polumbarët e forcat RENEA në kërkim për gjetjen e trupit
13 Dhjetor 2023, 14:40

Vrasja e Santiago Malkos, rrëfehet Blendi Teta: Nuk e njihja! Ervis Martinaj më kërcënoi se do më muroste nëse nuk i tregoja vendndodhjen e vëllezërve Duka
Keli Banushi
6 Dhjetor 2023, 10:14

I fundit që takoi të shumëkërkuarin Ervis Martinaj para se të zhdukej, del nga burgu ish-polici i Operacionales Jeton Lami
24 Nëntor 2023, 12:30

Në kërkim nga SPAK, kush është Ervin Mata! Krushqi me Erzen Breçanin dhe lidhja e dikurshme me Elvana Gjatën! Truproja e tij vrau në 2018 mikun e Ervis Martinaj
21 Nëntor 2023, 10:54

VIDEO/ FNSH dhe forcat operacionale pika kontrolli në hyrje të autostradës së Vlorës
Armand Xhelili
11 Nëntor 2023, 12:50

Arrestimi i kushëririt të Ervis Martinajt, policia: Ishte në kërkim edhe për dhunë në familje
13 Tetor 2023, 09:38

VIDEO/ RENEA e Operacionalet 'mësyjnë' sërish Vlorën,14 të shoqëruar! Bllokohet dhe një makinë e blinduar e dy luksoze
2 Tetor 2023, 21:58

FNSH zbarkon në Vlorë, kryen kontrolle për persona që lëvizin me armë apo të shpallur në kërkim
30 Shtator 2023, 19:04

A ka vdekur Ervis Martinaj? Dumani jep pëgjigje për zhdukjen e "mbretit" të lojrave të fatit
29 Shtator 2023, 18:28

RENEA dhe FNSH sërish kontrolle në Vlorë, një i shoqëruar! Mbrëmë u arrestuan 6 anëtarë të një grupi kriminal
18 Shtator 2023, 21:42

© 2011 - 2024 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje